



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 170

Tiranë – E martë, 22 shtator 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11705, datë 11.9.2020	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 12137
Vendim i Kuvendit nr. 50/2020, datë 17.9.2020	Për krijimin dhe përbërjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Shqyrtimin dhe Përzgjedhjen e Kandidaturave për Organet Drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve: Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve..... 12137
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 735, datë 16.9.2020	Për miratimin e letërmarrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara, për rimbursimin e TVSH-së për 31 respiratorë..... 12138
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 33, datë 26.8.2020	Për kushtet e tjera që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme..... 12140
Kërkesë e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 5008/3, datë 17.9.2020	Për shpronësim për interes publik të pasurive pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i zonës fundore të sheshit ‘Santa Barbara’ dhe ndërtimi i godinës së Bashkisë Divjakë”..... 12141
Kërkesë e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 6644, datë 18.9.2020	Për shpronësim për interes publik të pasurive pronë private, që preken nga projekti “Sistemimi i kryqëzimit të Rrugës së Durrësit me Unazën, Tiranë”..... 12144

**DEKRET****Nr. 11705, datë 11.9.2020****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, germa “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Bekim Osman Xhoni
2. Kolë Nuo Thaqi
3. Shpejtim Shaban Ahmetaj
4. Shaip Halit Havolli
5. Jehona Sahit Havolli (Sahiti)
6. Mirlinda Shaip Havolli
7. Ardian Shaip Havolli
8. Erëza Shaip Havolli
9. Tringa Valdet Kastrati
10. Mergim Xhavit Cahani
11. Özgür Mehmet Ali Ünal

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Ilir Meta**VENDIM****Nr. 50/2020****PËR KRIJIMIN DHE PËRBËRJEN E
KOMISIONIT TË POSAÇËM
PARLAMENTAR PËR SHQYRTIMIN
DHE PËRZGJEDHJEN E
KANDIDATURAVE PËR ORGANET
DREJTUESE TË KOMISIONIT
QENDROR TË ZGJEDHJEVE:
KOMISIONERIT SHTETËROR TË
ZGJEDHJEVE, NËNKOMISIONERIT
SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE,
KOMISIONIT RREGULLATOR DHE
KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE
DHE SANKSIONEVE**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, nenit 55, të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, me propozimet e grupeve parlamentare,

KUVENDI**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Shqyrtimin dhe Përzgjedhjen e Kandidaturave për Organet Drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve: Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, sipas ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

II. Përbërja e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Shqyrtimin dhe Përzgjedhjen e Kandidaturave është si më poshtë:

a) Nga grupi parlamentar i shumicës parlamentare caktohen:

1. Damian Gjiknurikryetar (Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste)

2. Alket Hysenianëtar (Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste)

3. Adnor Shametianëtar (Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste)

b) Nga grupet parlamentare të pakicës parlamentare caktohen:



1. Myslim Murrizianëtar(Grupi Parlamentar Demokrat)

2. Edmond Stojkuanëtar(Grupi Parlamentar Demokraci dhe Drejtësi)

III. Procedura e shqyrtimit dhe e përzgjedhjes kryhet sipas dispozitave të Rregullores së Kuvendit për zgjedhjen në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj, përveçse kur përcaktohet ndryshe në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

IV. Përzgjedhja e kandidaturave, sipas ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet në prani të përfaqësuesit të autorizuar, me cilësinë e të dërguarit të posaçëm, të partive parlamentare të dala nga zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017, që kanë humbur përfaqësimin parlamentar.

V. Komisioni e përfundon veprimtarinë e tij brenda datës 2 tetor 2020. Në rast nevojë, me kërkesë të arsyetuar dhe vendim të Komisionit, Kuvendi vendos zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së Komisionit.

VI. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për krijimin e kushteve të punës, si dhe për mbështetjen me burime njerëzore, financiare dhe logjistike të veprimtarisë së këtij Komisioni të Posaçëm.

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 17.9.2020.

VENDIM
Nr. 735, datë 16.9.2020

PËR MIRATIMIN E
LETËRMARRËVESHJES NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE, DHE PROGRAMIT PËR
ZHVILLIM TË KOMBEVE TË
BASHKUARA, PËR RIMBURSIMIT E
TVSH-së PËR 31 RESPIRATORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me

propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e letërmarrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara, për rimbursimin e TVSH-së për 31 respiratorë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

PROGRAMI PËR ZHVILLIM I KOMBEVE TË
BASHKUARA

Tiranë, 13 korrik 2020

E nderuar Ministre Manastirliu

Lënda: Blerja e 31 ventilatorëve

Në kuadër të Lehtësimit të Angazhimit të PNUD-it “Reagimi ndaj COVID-19 në Shqipëri”, të cilën e kemi nënshkruar bashkërisht më 10 prill me ambasadorët e nderuar të Zvicrës dhe të Norvegjisë, kam kënaqësinë t’ju informoj se të gjithë ventilatorët tashmë kanë mbërritur në Shqipëri dhe u dorëzuan dhe u instaluan në spitalin “Nënë Tereza”.

Me kontributin nga qeveritë e Zvicrës, Norvegjisë, si dhe PNUD-it, kemi mbështetur Qeverinë e Shqipërisë në blerjen e 31 ventilatorëve si pajisje urgjente mjekësore në përgjigje ndaj COVID-19 dhe duke garantuar që sistemi shëndetësor shqiptar është pajisur më tej për luftimin e pandemisë.

Unë, gjithashtu, do të dëshiroja t’ju falënderoja për bashkëpunimin e vazhdueshëm të Ministrisë për të trajtuar çështjen e mbetur të TVSH-së dhe vlerësoj konfirmimin tuaj që ventilatorët do të mbeten në spitalin “Nënë Tereza” dhe që, sipas marrëveshjes së nënshkruar, mirëmbajtja e tyre do të sigurohet nga Ministria.

Më lejoni të ritheksoj falënderimet e mia për ju dhe qeveritë e Zvicrës dhe të Norvegjisë për



bashkëpunimin dhe për mbështetjen e ofruar në Shqipëri në këtë krizë të paprecedentë, duke ofruar pajisje shëndetësore, e cila mund të shpëtojë jetë njerëzish.

Me respekt,
Limya Eltayeb
Përfaqësuese Rezidente
Nënshkrimi dhe vula

Shkëlqesia e saj znj. Ogerta Manastirliu
Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Republika e Shqipërisë

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD), rruga “Skënderbej”, Gurten Center, kati 2, Tiranë, Shqipëri.

Tel.: +355 4 2250205; 4 250224; e-mail:

registry.al@undp.org; faqe interneti:

www.undp.org.al.

PROGRAMI PËR ZHVILLIM I KOMBEVE TË BASHKUARA

Tirana, 14 korrik 2020

E nderuar znj. Manastirliu

Lënda: Rimbursimi i TVSH-së për 31 ventilatorë

Në kuadër të Lehtësimit të Angazhimit të PNUD-it “Reagimi ndaj COVID-19 në Shqipëri”, të cilën e kemi nënshkruar bashkërisht më 10 prill me ambasadorët e nderuar të Zvicrës dhe të Norvegjisë, jam i kënaqur që Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara ishte i aftë të mbështeste me prokurimin dhe dhurimin e 31 ventilatorëve për Këshillin e Ministrave, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për të menaxhuar situatën e pandemisë të shkaktuar nga përhapja e shpejtë e infeksionit COVID-19. Kjo ishte e mundur për shkak të kontributeve nga Qeveria e Zvicrës dhe e Norvegjisë, si dhe Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD). Nëpërmjet këtij procesi, ne shpresojmë të kemi mbështetur Qeverinë e Shqipërisë në blerjen e ventilatorëve si pajisje urgjente mjekësore në përgjigje ndaj COVID-19 dhe duke garantuar që sistemi shëndetësor shqiptar të jetë i pajisur më tej për luftimin e pandemisë.

Siç është rënë dakord ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD-it), ne tashmë e kemi paguar shumën e TVSH-së lidhur me ventilatorët gjatë përfundimit të procedurave të zhdoganimit, me qëllim që të përshpejtojmë zhdoganimin dhe dorëzimin e këtyre ventilatorëve te përfituesi përfundimtar, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, brenda periudhës më të shkurtër të mundshme. Qeveria Shqiptare, nga ana tjetër, u zotua për të rimbursuar, brenda periudhës më të shkurtër të mundshme, shumën e TVSH-së tashmë të parapaguar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD). 31 ventilatorët, modeli VG70, i janë dhënë në dorëzim Spitalit Universitar “Nënë Tereza”, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur.

TVSH-ja totale e paguar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD) arrin në 13,663,270 lekë, sipas dokumenteve të zhdoganimit, bashkëlidhur si shtojca 1. Kjo shumë do të depozitohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Llogarinë Bankare shqiptare të PNUD-it në Bankën Intesa SanPaolo, pas nënshkrimit të kësaj letërmarrëveshjeje.

Emri i bankës: Intesa Sanpaolo Bank

Emri i llogarisë: Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD)

Llogaria nr.: 1003730902

SWIFT: USALALTR

IBAN nr.: AL60208110080000001003730902

Monedha: Lek

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD) në Shqipëri dhe unë e vlerësojmë realisht bashkëpunimin që kemi pasur dhe dëshirojmë t'i përcjellim ekipit tuaj dhe juve, sigurinë e konsideratës sonë më të lartë.

Me respekt,

Znj. Limya Eltayeb,
Përfaqësuese Rezidente
PNUD Shqipëri

Rënë dakord nga:

Znj. Ogerta Manastirliu,
Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

**UDHËZIM****Nr. 33 datë 26.8.2020****PËR KUSHTET E TJERA QË DUHET TË
PLOTËSOJNË STREHËT E
PËRKOHSHME**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 3, të nenit 55, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

1. Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë kushte të tjera që duhet të përdoren gjatë projektimit, ndërtimit, rinovimit, blerjes ose marrjes me qira të hapësirave për programin e strehëve të përkohshme, sipas ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”.

2. Strehët e përkohshme përdoren në përputhje me ligjin nr. 22/2018, “Për strehimin social”. Normat, kushtet teknike, standardet e strehimit dhe të ndërtimit dhe vendndodhjet e strehëve të përkohshme të strehimit social respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, dinjitetin njerëzor dhe integritetin e përfituesve, parimin e mosdiskriminimit, atë të përshtatjes me nevojat e veçanta dhe kushtet shëndetësore, sigurinë, higjienën, sigurojnë hapësirat bazë dhe mbrojtje nga kushtet klimatike dhe atmosferike, si dhe krijojnë mundësinë e përfitimit të aksesit në shërbime komunitare dhe të një jete komunitare.

3. Çdo normë, kusht teknik apo standard ndërtimi për strehët e përkohshme, sipas ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, që nuk parashikohet në këtë udhëzim, zbatohet në përputhje me normat, kushtet teknike dhe standardet e ndërtimit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

4. Tipologjia e strehëve të përkohshme, në varësi të situatave kur përdoren, është:

a) fjetore, që janë ndërtesa të posaçme, të përshtatura kryesisht si struktura të përhershme për të pritur flukse të parashikuara apo të paparashikueshme të pastrehësh. Në raste të veçanta, fjetoret, të cilat përmbushin të njëjtat kushte me ndërtesat e zakonshme, mund të jenë

ndërtime të lëvizshme, të përkohshme apo të montueshme/çmontueshme;

b) kampe strehimi, që janë struktura të përkohshme që ngrihen për të përballuar flukse të paparashikuara të pastrehësh që vijnë si rezultat i një emergjence dhe ngrihen kryesisht kur ndodhin fatkeqësi natyrore, kriza, flukse refugjatësh apo situata të tjera emergjente.

5. Strehët e projektuara, të ndërtuara ose të përshtatura për programin e strehëve të përkohshme, sipas ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, mund të jenë struktura të posaçme, ndërtesa të përshtatura, si dhe ndërtime të përkohshme që mund të montohen, çmontohen dhe transportohen sipas nevojave. Tendat, shtëpizat e parafabrikuara, strehët e ndërtuara me materiale lokale etj. Janë, gjithashtu, disa nga format alternative të ndërtimit që mund të përdoren për të ofruar strehë të përkohshme.

6. Strehët e përkohshme duhet të ndërtohen, në zona që:

a) janë të pastra nga ndotja e ajrit, ndotja e tokës apo forma të tjera që përbëjnë rreziqe shëndetësore, kërcënime dhe rreziqe natyrore ose njerëzore, sipas legjislacionit në fuqi mbi mbrojtjen civile, mbrojtjen e mjedisit dhe cilësinë e ajrit në mjedis;

b) janë të ekspozuara ndaj rrezatimit diellor;

c) nuk janë të ekspozuara ndaj kushteve ekstreme klimatike;

ç) respektojnë legjislacionin në fuqi lidhur me ekspozimin ndaj nivelit të zhurmave;

d) ofrojnë akses të automjeteve, furnizim me ujë dhe energji elektrike;

dh) mundësojnë akses në shërbimet thelbësore, përmes transportit publik të rregullt ose të posaçëm.

7. Njësitë përgjegjëse, për ngritjen e kampeve të strehimit, zgjedhin zona që mundësojnë:

a) të paktën 30 m² sipërfaqe trualli për banor;

b) drenazhim të lehtë dhe sipërfaqe toke të përshkueshme. Pjerrësia e rekomanduar është nga 1% deri në 5%.

8. Vendorsja e strehëve të përkohshme bëhet në hapësira, që plotësojnë kushtet dhe parametrat e mëposhtëm:

a) pozicionohen ose orientohen me synimin për të maksimizuar ekspozimin nga jugu dhe për të ofruar ajrim të mirë;



b) krijojnë kushte për hapësira private dhe higjienë;

c) ofrojnë mbrojtje ndaj zjarrit dhe evakuim të lehtë;

ç) kur është e mundur, projektohen në to hapësira shoqërore të përbashkëta për banorët, si dhe hapësira të lojërave për fëmijë;

d) në rastin e kampeve të strehimit apo të fjetoreve me numër të lartë banorësh, për çdo grup prej 15–60 banorësh, ofrohen hapësira dhe shërbime shtesë, si: hapësira gatimi, hapësira ngrënieje/mensa, hapësira për kujdes mjekësor apo psikologjik, hapësirë publike, hapësira për fëmijët etj.;

dh) strehët duhet të krijojnë mundësi edhe për strehimin e të moshuarve dhe/ose personave me aftësi ndryshe, në mënyrë që të jenë të aksesueshme dhe përshtatshme për këto grupe shoqërore;

e) ofrojnë parkim për administratën dhe për vizitorët dhe sipas rastit, mund të ofrojnë vend parkimi për automjete apo biçikleta për banorët.

9. Strehët e përkohshme projektohen sipas kritereve të mëposhtme:

a) projektimi i mbështjellësës së strehës mundëson rrjedhje minimale të ajrit dhe rezistencë termike të lartë;

b) kur është e mundur, përdoren materiale ndërtimi miqësore për mjedisin;

c) lartësia minimale dysheme–tavan është të paktën 200 cm, dhe e rekomandueshme 240–265 cm;

ç) të gjitha hapësirat e banueshme duhet të kenë dritare ose dyer që mundësojnë ndriçim dhe ajrim natyral. Sipërfaqja e dritares duhet të jetë të paktën 1/10 e hapësirës neto të sipërfaqes së dhomës;

d) sigurojnë akses në ujë, energji elektrike dhe/ose gaz;

dh) projektimi mundëson ngrohje gjatë sezonit të ftohtë dhe freskim gjatë periudhës së nxehtë.

10. Strehët e përkohshme ngrihen sipas kërkesave funksionale të mëposhtme:

a) hapësirat e shërbimeve higjienike, të ndenjes, ngrënies dhe kuzhina mund të ndahen midis banorëve. Nëse këto hapësira janë të veçuara nga strehët, ato duhet të vendosen në një distancë nga 6 deri në 50 metra larg;

b) hapësirat sanitare dhe kuzhina duhet të furnizohen me ujë të ftohtë dhe të ngrohtë;

c) streha duhet të sigurojë të paktën hapësira fjetjeje të mbuluara dhe të sigurta për banorët;

ç) për çdo familje duhet të sigurohen hapësira të veçanta dhe të sigurta;

d) hapësirat e strehëve dhe të shërbimeve duhet të pajisen me mobilie, pajisje dhe sende të përshtatshme për të garantuar funksionalitetin dhe standardet e duhura të jetesës.

11. Strehët e përkohshme ofrojnë hapësirat dhe funksionet minimale, si vijon:

a) jo më pak se 3.5 m² për banor në hapësirën e strehës, duke përfshirë shërbimet sanitare dhe gatimin;

b) 1 m² kuzhinë dhe hapësirë ngrënieje për banor;

c) 1 WC i përbashkët për çdo 15 banorë, të ndara sipas seksit;

ç) 1 dush për çdo 30 banorë, të ndara sipas seksit;

d) 1 çezmë për çdo 50 persona.

12. Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore, ministria përgjegjëse për strehimin, si edhe çdo institucion publik ose privat që financon ndërtimin e strehëve të përkohshme për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE
EKONOMISË
Anila Denaj

KËRKESË
Nr. 5008/3, datë 17.9.2020

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i zonës fundore të sheshit ‘Santa Barbara’ dhe ndërtimi i godinës së Bashkisë Divjakë”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Divjakë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim dhe/ose për shkëmbim, për interes publik, për



pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, si:

1. Për pasuritë e llojit “truall” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

2. Për pasuritë e llojit “ndërtesë” dhe “banesë”, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen”, të ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo

më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Divjakë, si dhe në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 4 263 424.81 (katër milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e katërqind e njëzet e katër pikë tetëdhjetë e një) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli



TABELA E VLERËSIMIT PARAPRAK PËR PASURITË PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “REHABILITIMI I ZONËS FUNDORË TË SHESHIT ‘SANTA BARBARA’ DHE NDËRTIMI I GODINËS SË BASHKISË DIVJAKË”

Nr.	Emër Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e përgj. e truallit m ²	Sip. e prekur e truallit në m ²	Çmimi për truall (lek/m ²)	Vlera e truallit	Sipërfaqja e ndërtimit në kartelë	Sip. e ndërtesës, sipas faktit (m ²)		Sip. e prekur e ndërtesës (m ²)	Sipërfaqja totale e ndërtesës që shpronësohet (m ²)	Vlera e ndërtesës (lek)	Vlera e përgjith. truall + ndërtesë (lek)	Gjendja juridike	Statusi juridik
									Kat shërbimi (m ²)							
									Kati përdhes (m ²)	Kati I (m ²)						
1	Filip Gorreja, Natasha Gorreja	1492	630/83	190	190	514	97,660.0	173	145	0	145	145	2,504,646.52	2,602,306.52	Konfirmim nga ASHK-ja.	Nuk ka shënime.
2	Filip Gorreja, Natasha Gorreja	1492	630/98	310	310	514	159,340.0	0	0	0	0	0	-	159,340.00	Konfirmim nga ASHK-ja.	Nuk ka shënime.
3	Nerenxe Mehmeti	1492	630/88	120	120	514	61,680.0	120	107	0	107	107	910,158.08	971,838.08	Konfirmim nga ASHK-ja.	Nuk ka shënime.
4	Prokop Vodo	1492	630/78	60	60	514	30,840.0	42	42	0	42	42	499,100.21	529,940.21	Konfirmim nga ASHK-ja.	Nuk ka shënime.
VLERA PARAPRAKË														4,263,424.81		



KËRKESË
Nr. 6644, datë 18.9.2020

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga projekti “Sistemimi i kryqëzimit të Rrugës së Durrësit me Unazën, Tiranë”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në vendimin e Këshillit të

Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë për interes publik”, të ndryshuar, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 35 035 735 (tridhjetë e pesë milionë e tridhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë) lekë.

ZËVENDESMINISTËR I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

LISTA PARAPRAKE E SHPRONËSIMIT TË PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTI
“SISTEMIMI I KRYQËZIMIT TË RUGËS SË DURRËSIT ME UNAZËN, TIRANË”

Nr.	Emër Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m ²)	Sipërfaqe shpronësimi	Çmimi	Vlera totale/lek	Shënime: Konfirmuar ose jo nga ZVRPP-ja
						Tokë truall/m ²	Tokë truall/m ²		
1	Bp. Metashi, Sulejmani, Mero, Bushkovi	8210	3/130	Truall	107	107.0	38,164	4,083,548	
2	Bihane Ferzani	8210	3/124	Truall	38	38.0	38,164	1,450,232	
3	Myrteza Myftari	8310	6/282	Truall	805	805.0	31,219	25,131,295	Kufizohen veprimet. Dosja me referencë 04057, sekuestruar nga Prokuroria.
4	Bp. Ylli, Gjinali, Myftiu dhe Llagami	8310	6/1304	Truall	778.3	140.0	31,219	4,370,660	
VLERAT TOTALE E SHPRONËSIMIT								35,035,735	

Shënime:

1. Vlerësimi i tokës truall është llogaritur bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 84 lekë